



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 516 Prot.

Tiranë, më 08.04 2019

VENDIM Nr. 92, datë 04.04.2019

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"** Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, datë 04.04.2019, pasi shqyrtoi Projektin kërkimor shkencor në vazhdim **"Forumi Romak-Butrint" 2019**, drejtuar nga Prof.Dr.Luan Përzhita (IA) dhe Prof. Dr. David Hernandez (Universiteti i Notre Dame, SHBA), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projektin kërkimor shkencor në vazhdim **"Forumi Romak-Butrint" 2019**, drejtuar nga Prof.Dr.Luan Përzhita (IA) dhe Prof. Dr. David Hernandez (Universiteti i Notre Dame, SHBA), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - *Sondazh në Sektorin 22*, në anën veriore të Forumit, me qëllim identifikimin e fazave të ndërtesave të cilat janë aktualisht të paidentifikuara në lindje të ndërtesës trekëndore.
 - *Sondazh në Sektorin 23*, në cepin juglindor të Forumit, me qëllim që të përfshijmë një datim të saktë të mbetjeve të ujësjellësit, duke përfshirë dy faza të tubave dhe për të datuar anën jugore të Bazilikës Romake.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al